

Nr. 144 Prot.

Tiranë më 14.07.2022

Drejtuar: Z. Arben Kraja, Drejtues
Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

Lënda: Informacion shtesë mbi aferën e inceneratorëve

I nderuar Z. Kraja,

Në vijim të deklaratës dhe qëndrimit që kam mbajtur sot nga foltorja e selisë së Partisë Demokratike të Shqipërisë, lidhur me dokumenta dhe fakte të reja mbi aferën e inceneratorëve, ju përcjell bashkëlidhur dokumentat që disponojmë, përkatësisht kontratën e mbikqyrjes së punimeve me inceneratorin e Tiranës, datë 04.03.2018, Kontratë Shërbimi, “Shërbim i mbikqyrjes për punimet e ndërtimit në zbatim të kontratës koncensionare me objekt ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i venddepozitimit ekzistues Tiranë dhe prodhimit të energjisë elektrike”, në vlerën 649,440 euro dhe konfirmimin e kësaj kompanie për mbylljen e punimeve për inceneratorin e Fierit, Nr. 153 Prot., datë 31.03.2021, “Njoftim për përfundimin e punimeve të projektit objekt i kontratës koncensionare Për ndërtimin e Administrimin e Impjantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimit të energjisë elektrike”.

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

DEPUTET



Belind Këllici

Datë 04 .03 .2018

KONTRATË SHËRBIMI

**“SHËRBIM MBIKQYRJE PËR PUNIMET E NDERTIMIT NE ZBATIM TE KONTRATES
KONCESIONARE ME OBJEKT PËR NDERTIM LANDFILLI, INCENERATORI DHE
REHABILITIMI I VENDDEPOZITIMIT EKZISTUES TIRANE DHE PRODHIMIT TE
ENERGJISE ELEKTRIKE”**

Tiranë 2018

KONTRATË

Lidhur sot më datë 04/03/2018, midis palëve:

Me cilësinë e "Përfituesit të shërbimit":

Shoqëria "Integrated Energy BV SPV" shpk, nje shoqëri e themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, me NIPT L72031013B dhe adrese TIRANE Njesia Administrative Nr.5, Bulevardi Gjergj Fishta, Nr.48, e përfaqësuar nga administrator Z. Giuseppe Ciaffaglione madhor me zotesi te plote për te vepruar., këtu e më poshtë "**Perfituesi**"

dhe

Me cilësinë e "Kontraktuesit":

Shoqërisë "AVE Consulting" sh.p.k. me adresë: Rruga "Tish Daija", Njësia Bashkiake Nr. 5, Pall. 7, Ap. 28 (Kompleksi Kika i Ri) Tiranë, të përfaqësuar nga z.Arben Dervishaj, në cilësinë e Administratorit të shoqërisë "AVE Consulting" sh.p.k. me NUIS K81321002M i cili më poshtë do të quhet "**Kontraktues**".

Pas shpalljes se Shoqërisë Kontraktuese si fituese te procedures konkurruese me objekt : "Sherbim mbikqyrje per punimet e ndertimit ne zbatim te kontrates koncesionare me objekt Per Ndertim Landfilli, Inceneratori dhe Rehabilitimi i Venddepozitimit Ekzistues Tirane dhe Prodhimit te Energjise Elektrike" (ZTMT) ne Tirane te zhvilluar nga ana e Shoqërisë Perfituese te shërbimit, Palet e mesiperme bien dakort te lidhin kete kontrate me kushtet si me poshte vijon:

Neni 1 Përkufizime

1. "**Kontratë**" do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis "**Perfituesi**" dhe "**Kontraktuesit**", që përbëhet nga dokumentet që përfshihen në referimin e çdo dokumenti, apo neneve të kësaj kontrate.
2. "**Çmim kontrate**" do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
3. "**Objekt i kontratës**" do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
4. "**Palë (t)**" do të thotë nënshkruesit e kontratës.
5. "**Shërbime**" do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
6. "**Termat e Referencës**" shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 2 Objekti

1. Objekt i kësaj kontrate është realizimi i: "**Sherbimit te mbikqyrjes per punimet e ndertimit ne zbatim te kontrates koncesionare me objekt Per Ndertim Landfilli, Inceneratori dhe Rehabilitimi i Venddepozitimit Ekzistues Tirane dhe Prodhimit te Energjise Elektrike**" (ZTMT) ne Tirane, në përputhje me legjislacionin ne fuqi dhe kushtet e kesaj kontrate.

Neni 3 Çmimi i kontratës

1. Kontraktuesi merr përsipër të realizojë kontratën sipas objektit të lartpërmendur kundrejt vlerës totale prej **649 440 Euro (gjashtëqindëzeteenentemije e katerqindëzete euro)**, pa TVSH, vlerë kjo e ofertuar sipas Ofertes Ekonomike me Nr. Prot 01 të datës, e cila është bashkëlidhur kësaj kontrate si pjesë integrale e saj.
2. Çmimi i kontratës nuk mund të ndryshohet përgjate gjithë kohezgjatjes së saj.
3. Çmimi i kontratës përfshin shumën totale që **“Perfituesi”** është i detyruar t’i paguajë **“Kontraktuesit”** për vlerën e plotë të shërbimit.
4. Pagesa do të kryhet në numrin e llogarisë Pranë Bankës BKT me numer
5. Perfituesi:
Llogaria në monedhën ALL AL- 4920511564249175 CLPRCL ALLF.
Llogaria në monedhën EURO AL-7020511564249175 CLPRCF EURD.

Neni 4 Kushtet dhe afatet e pagesës

Pagesa do të bëhet çdo 3 muaj, me dorëzimin e Raportit 3- mujor të mbikqyresit të punimeve dhe me leshimin e faturës tatimore.

Koha e kontratës do të jetë maksimumi 6 vite. Nëse **“Perfituesi”** do ta realizojë projektin në periudhë me të shkurter kohore pagesa kundrejt **“Kontraktuesit”** do të bëhet e plotë.

Pagesa do të kryhet në monedhën euro, ashtu sikurse është parashikuar në kontratë, ose në monedhën leke me kursin e këmimit të Bankës së Shqipërisë të datës së faturës.

Komisionet për pagesat, në rast se kryhen nga banka të ndryshme për arsye të volitshme, duhet që secila palë të paguajë komisionet e veta.

Neni 5 Vonesa në bërjen e pagesës

1. Dëmet e llogaritura, të shkaktuara si rezultat i vonës në pagesë, konsistojnë në kamatën që fillon nga data e vonës së debitorit **“Perfituesit”**, në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamatës do të jetë 0.1% të vlerës korresponduese të mbetur pa u paguar nga vlera totale e kontratës por kjo vlerë në çdo rast do të llogaritet jo me shumë se 15% e vlerës totale së kontratës.
2. Kamata ligjore paguhet pa detyruar kreditorin (Kontraktuesin) të provojë ndonjë dëm. Nëse kreditori (Kontraktuesi) provon se ka pësuar një dëm më të madh se kamata ligjore, debitorin **“Perfituesi”** duhet të paguajë pjesën e mbetur të dëmit.

Neni 6 Formimi i kontratës

1. Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës, së bashku me anekset e saj, duke trupëzuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.
2. Kushtet e veçanta të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

Neni 7
Hyrja në fuqi e kontratës

1. Kontrata hyn në fuqi kur plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - a) Kontrata të jetë nënshkruar nga të dyja palët.

Neni 8
Kohëzgjatja e kontratës

1. Afati i vlefshmërisë së kësaj kontrate është duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate, e deri në perfundimin e punimeve, pra me nënshkrimin e Procesverbalit të Perfundimit të Punimeve për ndertimin total të objektit të kontratës së koncesionit, që Perfituesi i Shërbimit ka lidhur me Autoritetin Kontraktues Ministria e Mjedisit (Me tej Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë).
2. Afati i vlefshmërisë së kontratës mund të ndryshohet vetëm nëse palët bien dakord me shkrim.

Neni 9
Afati dhe kushtet e lëvrimit

1. Realizimi i shërbimit, sipas Nenit 2 të kontratës, do të bëhet brenda kohëzgjatjes që është parashikuar në **nenin 6** të kësaj kontrate.
2. Vendi i realizimit të shërbimit do të jetë në Sharre, pranë Zonës së Trajtimit të Mbetjeve Tirane.
3. Realizimi i shërbimit do duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:
 - a. Faturën tatimore të shërbimit;
 - b. Raport i Mbikqyresit të Punimeve,

Si dhe gjithë dokumentacionin ligjor (nese kerkohet).

Neni 10
Detyrimet e përgjithshme të kontraktuesit

1. Kontraktuesi do të ofrojë shërbimin, objekt kontrate, në mënyrë profesionale, bazuar në lejet dhe licencat që disponon, në përputhje me standardet dhe me të gjitha aktet normative në fuqi.
2. Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuara dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.
3. Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesë dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
4. Kontraktuesi, në asnjë rast, nuk duhet të transferojë, apo kalojë tek të tretët, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës pa miratimin paraprak me shkrim të "Perfituesit".
5. Kontraktuesi duhet t'i paraqesë "Perfituesit" shërbimin, në mënyrën e përcaktuar, siç specifikohet në nenet e kësaj kontrate.



Neni 11 Detyrimet e veçanta të kontraktuesit

1. Sherbimi i konsulences duhet të përmbajë në mënyrë të qartë këto çështje kryesore:
 - Te realizoje kontrollin teknik te punimeve ne objekt.
 - Te jape konsulence teknike ne raste te problemeve teknike te hasura gjate zbatimit te projektit.
 - **“Kontraktuesi”** pergjigjet per realizimin e çdo pike te kontrates se nenshkruar midis **“Kontraktuesit”** dhe **“Perfituesit”** gjithashtu per te gjitha kushtet e percaktuara ne kontraten e Koncesionit te lidhur ndermjet **Perfituesit** dhe Autoritetit Kontraktues Ministria e Mjedisit (Me tej Ministria e Infrastruktures dhe Energjise), per realizimin e fazave te ndryshme te zbatimit, respektimit te afatit te dorezimit dhe koston se objektit si dhe do te zbatoje detyrat e tij te vendosura ne kushtet e kesaj kontrate.
 - Te ofroje konsulence teknike per projektin dhe punimet qe do te realizohen ne objekt.
 - **“Kontraktuesi”** mban dhe pergjigjet per dokumentacionin si me poshte:
 - Projekt-zbatimin e fitmosur nga projektuesit dhe te miratuar nga **“Perfituesi”**.
 - Dokumentacionin inxhinierik te punimeve.
 - Dokumentacionin perkates per te gjitha ndryshimet e mundshme qe mund te jene bere ne projekt gjate ndertimit te objektit pa prekur kushtet e vena nga **“Perfituesi”**.
 - Planorganizimin e punimeve (Grafiku i Punimeve).
 - **“Kontraktuesi”** eshte i detyruar te kontrolloje, periodikisht dhe ne fazat me kryesore, librin e kantierit dhe eshte pergjegjes per saktesine dhe vertetesine e dokumentave qe pasqyrohen ne te.
 - **“Kontraktuesi”** duhet te beje verifikimet paraprake lidhur me dokumentacionin perkates, te licensave, autorizimeve, lejeve qe meren para fillimit te punimeve verifikimin e sheshit te ndertimit, nese eshte i lire dhe i gatshem per te filluar si dhe te njohe me hollesi kontraten e koncesionit dhe gjithe dokuentat e tjera qe lidhen me te per zbatimin e saj.
 - **“Kontraktuesi”** verifikon tabelen e identifikimit me te dhenat e parashikuara ne piken 5/c; te Udhezimit Nr .3, date 15.02.2001 te Keshillit te Ministrave.

Neni 12 Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 13 Nënkontrata dhe transferimi i të drejtave

1. Kontraktuesi nuk mund të nënkontrakttojë asnjë pjesë të kësaj kontrate pa aprovimin paraprak me shkrim të **“Perfituesit”**.

2. Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës pa miratimin paraprak me shkrim të **"Perfituesit"**.

Neni 14 Forca Madhore

1. Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.
2. Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e **"Perfituesit"** qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.
3. Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë **"Perfituesin"**. Me përjashtim kur **"Perfituesi"** jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 15 Likuidimi për dorëzimin e vonuar

1. Dëmet e likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimit do të llogariten me tarifa ditore si më poshtë:
 - o 1/100 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë në çdo rast do të llogaritet maksimalisht sa 15% të vlerës së kontratës.

Neni 16 Zbatimi i kontratës, ndërprerjet, vonesa në zbatim dhe zgjatja e afatit

1. Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.
2. Me përjashtim kur **"Perfituesi"** është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, **"Perfituesi"** ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në realizimin dhe/ose dorëzimin e shërbimit brenda periudhës së zbatimit të specifikuar në kontratë.
3. **"Perfituesi"** mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhen paguar nga shumën e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë **"Perfituesi"** duhet t'i japë Kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.
4. **"Perfituesi"** do të jetë dakord për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.
5. **"Perfituesi"** mund të jetë dakord për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë **"Perfituesin"** me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. **"Perfituesi"** duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse **"Perfituesi"** është dakord me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga të dy palët.



Neni 17
Negociatat dhe amendamentet

1. Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit në procedurën konkurruese të shpallur nga Perfituesi.
2. Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qenë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe **"Perfituesit"**.
3. Çdo heqje dore nga të drejtat, detyrimet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga të dy përfaqësuesit e autorizuar të palëve ku duhet të specifikohet e drejta dhe masa në të cilën ajo do të zbatohet.

Neni 18
Ndryshimi i Porosisë

"Perfituesi" brenda kesaj kontrate nuk mund të porosisë Shërbime shtesë pa miratim me shkrim nga kontraktuesi.

"Perfituesi" brenda kesaj kontrate mund të porosisë ndryshime të shërbimeve të dorëzuara për një sasi që nuk i kalon 10% të çmimit total të kontratës.

Neni 19
Ndërprerja për Mosplotësim

1. **"Perfituesi"** mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
 - a) Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
 - b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.
2. **"Perfituesi"** duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit pesë ditë afat të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Neni 20
Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

1. **"Perfituesi"** mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton.
2. **"Perfituesi"** duhet t'i japi **"Kontraktuesit"** njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 21
Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

1. **"Perfituesi"** mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.
2. **"Perfituesi"** duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.
3. **"Perfituesi"** duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesës së Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.



Neni 22
Informacioni konfidencial

1. Kontraktuesi është i detyruar të mbajë dhe ruajë konfidencialitetin për çdo informacion apo dokumentacion mbi/ose në lidhje me **“Perfituesin”** dhe që është i lidhur me objektin e kësaj kontrate, qoftë edhe pa aprovimin paraprak me shkrim nga **“Perfituesit”**.
2. Kontraktuesi nuk do të përdorë, publikojë, kopjojë, riprodhojë, transmetojë, transferojë të tretëve asnjë dokument, të dhënë, ose informacion tjetër në lidhje me kontratën.

Neni 23
Ndryshimet dhe zgjidhja e kontratës

1. Ndryshimet në përmbajtjen e Kontratës mund të bëhen vetëm me pëlqimin e të dy palëve dhe me shkrim.
2. Në qoftë se **“Perfituesi”** konstaton se Kontraktuesi nuk është duke përmbushur detyrimet e tij, në lidhje me objektin e kontratës, **“Perfituesi”** ka të drejtë të bëjë zgjidhjen e kontratës, në mënyrë të njëanshme dhe të menjëhershme, si dhe do të kërkojë shpërblimin e dëmit, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 24
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. **“Perfituesi”** dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkt.
2. Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.
3. Për të gjitha mosmarrëveshjet e tjera që nuk lidhen me zbatimin e procedurave standarde të verifikimit të shërbimit, nëse Palët nuk arrijnë zgjidhjen me mirëkuptim pas negociatave brenda 30 ditëve, atëherë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është Gjykata Kompetente.

Neni 25
Lajmërimet

1. Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, ose me e-mail në adresat zyrtare të paleve.
2. Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 26
Llogaritja e Afateve

Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.




Neni 27
Dispozita e fundit

1. Kjo kontratë është e detyrueshme dhe e vlefshme vetëm për palët nënshkruese.
2. Kjo Kontratë u formulua dhe u nënshkrua sot më datë 04.03.2018 në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe, dy nga të cilat i mban Përftuesi i Shërbimit dhe një kopje Kontraktuesi.

Perfituesi

“Integrated Energy BV SPV” shpk



Kontraktuesi

“AVE Consulting” sh.p.k





Almo Velzi
31.03.21

Nr. 153 Prot

Tiranë, më 31 /03/2021

LËNDA: Njoftim për përfundimin e punimeve të projektit objekt i kontratës koncesionare “Për Ndërtimin e Administrimin e Impjantin të Trajtimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier dhe Prodhimit të Energjisë Elektrike”

DREJTUAR: ZNJ. BELINDA BALLUKU

MINISTRE E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Tiranë

PËR DIJENI: NJËSIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT

Tiranë

PËR DIJENI: SHOQËRIA “INTEGRATED TECHNOLOGY WASTE TREATMENT FIER” SH.P.K

Tiranë

E nderuara Znj. Balluku

Në cilësinë e mbikqyrësit të punimeve të projektit, objekt i kontratës koncesionare Nr. 5553/5 Prot. datë 24/10/2016 “Për Ndërtimin e Administrimin e Impjantin të Trajtimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier dhe Prodhimit të Energjisë Elektrike”, lidhur midis shoqërisë “Integrated Technology Waste Treatment Fier” Sh.p.k dhe Ministrisë së Mjedisit si Autoritet Kontraktues (kaluar në kompetencë të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë), na lejoni t’Ju njoftojmë se, punimet për realizimin e kësaj vepre kanë përfunduar sot në datë 30/03/2021 dhe mund të vijohet me firmosjen e Proces-Verbalit të përfundimit të punimeve. Për këtë arsye kërkojmë nga ana Juaj përcaktimin e përfaqësuesve të Autoritetit Kontraktues, të cilët do të jenë të pranishëm dhe do të nënshkruajnë këtë proces-verbal.



Po kështu, në zbatim të pikës 10.7 “Testimi i veprës” të Kontratës Koncesionare shoqëria koncesionare “Integrated Technology Waste Treatment Fier” sh.p.k, është e gatshme që të fillojë me periudhën e testimit të veprës, për të cilën në zbatim të parashikimeve të kontratës koncesionare do të bëjë njoftimet përkatëse për datën dhe orën e kryerjes së testeve.

Gjithashtu duam t`ju bëjmë me dije se shoqëria “Integrated Technology Waste Treatment Fier” sh.p.k po merr masa për certifikimin e të gjithë komponentëve pjesë e Impiantit të Trajtimit të Mbetjeve Urbane nga shoqëri ndërkombëtare, të specializuara në fushat përkatëse.

Duke Ju falenderuar për mbështetjen Tuaj.

Me respekt

MBIKQYRËSI I PUNIMEVE

“AVE CONSULTING” SH.P.K.

Administrator

Arben Dervishaj

